

|                                                                                                                                                                            |                          |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|
|  AGENCIA PËR LUFTIMIN<br>KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCY FOR THE FIGHT<br>AGAINST CORRUPTION |                          |
| DPK/DMP<br>02                                                                                                                                                              | 03-4597/12<br>24.12.2012 |

**Re.l.nr.636/2012**

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DRAGASH**, gjyqtari Bekri Vehapi në procedurën kundërvajtse kundër të pandehurit Lulzim Rifaj nga Dragashi, për kundërvajtje sipas nenit 17 pika 1. të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë të zyrtarve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e dhuratave për të gjithë prsonat zyrtar, Ligji nr.04/L-050, e në bazë të nenit 73, 74 dhe neni 195 par. 1 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datën 17.12.2012, merrë këtë

## **A K T V E N D I M**

I PANDEHURI Lulzim Shaban Rifaj nga Dragashi, Shqiptar, Shtetasë i Republikës së Kosovës, kryesues i Asambles komunale në Dragash, i martuar prind i 3 femijve, me banim të përhershëm në Dragash.

## **ËSHTË PËRGJEGJËS**

Për arsye se si zyrtar i lartë publik- kryesues i asambles komunale në Dragash në afatin e përcaktuar ligjor, gjegjësisht deri me dt. 31.03. 2012, nuk e ka përmbushur obligimin ligjor, nuk e ka plotësuar dhe dorzuar formularin për deklarimin e pasurisë Agjencionit kundër korrupsionit të Kosovës në Prishtinë.

Me që rast i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 6. pika1 dhe 3, të sanksionuar sipas nenit 17 pika 1. të Ligjit nr.04/L-050, e në bazë të kësaj dispozite e konform neni 9 par 1. të LMK-së, bëhet zbutja e denimit dhe i pandehuri,

## **DENOHET**

**ME XHOBË në shumën prej 50 euro (pesëdhjeteuro).**

**Obligohet i pandehuri që xhobën ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmeris së këtij aktvendimi, në llogarin bankare për mes kësaj gjykate. Në të kundërtën do të bëhet arktimi i dhunshëm me aktvendim të veqant.**

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 Euro, njëlloj si edhe me xhobën..

## **A r s y e t i m**

Me kërkesën e Agjencionit kundër korrupsionit të Kosovës në Prishtinë, 01-2154/2012, të dt. 04.06.2012, Gjykata për kundërvajtje me konkluzion e ka filluar procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Lulzim Rifaj me të dhënat si në dispozitiv të aktvendimit.

I pandehuri Lulzim Rifaj në seancën e shqyrtimit verbal sipas proqesverbalit, gjegjësiaht përmes deklarimit me shkrim ka deklaruar se nuk ka qenë i njoftuar me dispozitën ligjore dhe se nuk ka patur në dispozicion formularin për deklarimin e pasurisë, se për këtë qështje për herë të parë është njoftuar nga gjykata për kundërvajtje. Ka deklaruar se me të u njoftuar me obligimin ligjor, menjëher me datën 02.08. 2012 e ka paraqit formularin dhe njëherit e ka bërë deklarimin e pasurisë. Ka kërkuar nga gjykata që gjatë vendosjes dhe

03-4597/12/02  
feng

marrëjes së aktvendimit të ketë parasysh faktet e prezentuara të cilat fakte do të shërbejnë si rrethana letësuese.

I pandehuri për dt. 20.11.2012, me rregull e ka pranuar thirjen, i ftuar drejtëpësdrejtë edhe përmes dërguesit të thirjeve të kësaj gjykate, nuk është paraqit në gjykat dhe nuk e ka justifikuar mungesën e tij.

Gjykata për vërtetimin e sakt të rrethanave të kundërvajtjes me dt. 07.12.2012, e ka ftuar dhe ka marrë deklaratën nga deshmitari - personi kontaktues i KK. Dragashit- Beqir Rashiti.

Deshmitari në seancën e shqyrtimit verbal sipas proqesverbalit ka deklaruar se me dt. 05.03.2012, me shkresën 02.Nr.zr. i ka njoftuar, njëherit i ju ka shpërndar aplikacionet e zbrazura të gjith personave të lartë zyrtar, përfshir edhe këshillëtarve të asambles komunale në Dragash, njëherit edhe kryesuesit të asambles komunale Lulzim Rifaj. Deshmitari në pytjen e gjykatës ka deklaruar se kryesuesi i asambles, Lulzim Rifaj mua si person kontaktues për vitin punues 2011-2012, nuk më ka dorzuar dhe se nuk jam në dijeni lidhur me dorzimin e formularit nga Lulzim Rifaj.

Gjykata ka lexuar shkresat së lëndës të Agjencionit kundër korrupsionit, deklaratën e të pandehurit, deklaratën e personit kontaktues, deshmit e prezentuara dhe pa dyshim është konstatuar dhe vërtetuar se i pandehuri Lulzim Rifaj si zyrtar i lartë publik i obliguar për ta deklaruar pasurin, në afatin e përcaktuar ligjor si në dispozitiv, nuk e ka plotësuar dhe nuk i ka derguar formularin Agjencionit më së voni deri më dt.31.03.2012.

Me këto veprime ka kryer kundërvajtje nga neni 6.pika 1 dhe 3, të sanksionuar me nenin 17 pika 1. të Ligjit nr/04/L-050

Gjykata ndaj të pandehurit konform nenit 9 par.1 të LMK-së e ka bër zbutjen e denimit nga rrethanat, se i pandehuri për herë të parë ka kryer kundërvajtje të kësaj natyre, nga rrethanat se me dt.02.08.2012, përmes formularit e ka bër deklarimin e pasurisë dhe e ka njoftuar Agjencionin kundër korrupsionit.

Me sa u tha me lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTEJE NË  
DRAGASH, Me datën 17.12.2012, Re.I.nr 636/2012.**

Gjyqtari për kundërvajtje,  
Beqir Vehapi

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktvendimi parashtuesi i kërkesës dhe i pandehuri kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e lartë për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa dërgohet me shkrim me 2.egzenpilar pa taksa përmesë Gjykatës komunale për kundërvajtje në Dragash.